



Pranuar / Doretuar Priljena / Predato Received / Delivered	18.06.2021	1	viti god year
Organ / Njesta Organ / Jedinica Org. / Unit	SKANSK	3190/2021	Sasia Kolicina Quantity
			114



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.360/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Çlirim Zeka - Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.360/2021 të datës 05.05.2021 të parashtruar nga ankuesi nga Lipjani, kundër organit të punësimit Komuna e Lipjanit, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 16.06.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.360/2021 e datës 05.05.2021, e parashtruar nga ankuesi
- II. Detyrohet Kryetari i Komunës së Lipjanit, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme administrative në mënyrë që ankuesit ti kompensohet shuma e pagës së ndaluar prej 50%, ashtu siç është përcaktuar me Vendimin Nr.1-112-10129 të datës 19.02.2021 për kthimin e ankuesit në vendin e punës.
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.
- IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Komunën e Lipjanit me datë 05.05.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 2184/2021 të regjistruar me numër A.nr.360/2021, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të mos zbatimit të Vendimit me numër Nr.112-10129 të datës 19.02.2021 të Kryetarit të Komunës së Lipjanit dhe heshtjes administrative të Komunës së Lipjanit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 12.05.2021 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Komuna e Lipjanit. Ndërsa Këshilli me datë 24.05.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Komuna e Lipjanit se bashku me shkresat e lëndës lidhur me çështjen në procedurë të ankesës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas konstatimit së ankesa është e pranueshme sipas nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, për vendosje meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 2184/2021 të datës 05.05.2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 12.05.2021; ID e ankuesit; kartelen bankare e ankuesit, Vendimin me Nr. 1-112-10129 të datës 19.02.2021; Kërkesën e datës 02.03.2021; Përgjigjen në kërkesën me Nr. 1-112-18444 të datës 08.04.2021; Përgjigjen e datës 04.03.2021; Kërkesën për pagesën e mjeteve e datës 16.04.2021; Përgjigjen në ankesën e datës 24.05.2021; E-mailin nga R.H. për C.Z. i datës 21.05.2021; E-mailin nga R.H. për C.Z. i datës 21.05.2021; Kartelën e nëpunësit Driton Avdiu për vitin 2017, 2018, 2019, 2020, 2021; Akt Emërimit e datës 02.04.2012; E-mailin e datës 14.06.2021; Aktgjykimin APS.nr.33/2020 i datës 15.12.2020; Vendimin për pezullim parandalues me nr.1-116-6255 i datës 15.02.2017; E-mailin nga XH.Z. për C.Z. i datës 15.06.2021.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, pasi ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit dhe pas analizimit të të gjitha shkresave të lëndës, konstatoj se ankesa e ankuesit *është e bazuara, sepse:*

Bazuar në shqyrtimin e provave të lëndës Kolegji ka gjetur se me Vendimin Nr.1-116-6260 të datës 15.02.2017 të Kryetarit të Komunës së Lipjanit, ankuesi në pozitën e Inspektorit të Ndërtimitarisë, për shkak të ngritjes së Aktakuzës për keqpërdorim të autoritet zyrtar në bashkëkryerje, është pezulluar nga puna me pagesë prej 50 % të pagës së tij mujore gjatë kohëzgjatjes së pezullimit, duke u bazuar në nenin 69 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1.12. dhe 1.3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil.

Me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit/Departamenti Special me numër APS.Nr.33/2020 të datës 15.12.2020, është vërtetuar Pika II e pjesës liruese të Aktgjykimi PKR. Nr.206/2019 të datës 18.09.2020 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Krime të Rënda, sipas të cilit ankuesi Driton Avdiu është liruar nga aktakuza për veprë penale keqpërdorim i autoritetit zyrtar në bashkëkryerje nga neni 422 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Kryetari i Komunës së Lipjanit, në zbatim të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit/Departamenti Speciali me numër APS.Nr.33/2020 të datës 15.12.2020, me vendimin Nr.1-112-10129 të datës 19.02.2021, në pikën I të dispozitivit ankuesin e ka kthyer në vendim e tij të punës Inspektor i Ndërtimit, duke filluar nga data 01.03.2021, ndërsa në pikën II të dispozitivit ka obliguar Drejtoratin për Buxhet dhe Financa të Komunës së Lipjanit, që ankuesit ti kompensoj pagesën prej 50 % të pagës së ndaluar nga data e vendimi për pezullim Nr.1-111-6260 të datës 15.02.2017.

Ankuesi me datë 02.03.2021 ka parashtruar kërkesë me shkrim pranë Drejtorisë për Buxhet dhe Financa të Komunës së Lipjanit, për kompensim të pagesës sipas pikës II të vendimit Nr.1-112-10129 të datës 19.02.2021 të Kryetarit të Komunës së Lipjanit. Ndërsa Drejtoria për Buxhet dhe Financa, me datës 04.03.2021, ka bartë tek Udhëheqësja e Personelit të Komunës së Lipjanit, kalkulimin e 50 % të pagës së ankuesit për periudhën nga data 15.02.2017 deri 01.03.2021.

Ankuesi serish me datë 16.04.2021, parashtron kërkesë të Drejtorati për Buxhet dhe Financa lidhur me mos kompensimin e 50% të pagës së ndaluar gjatë kohë së pezullimit parandalues.

Pas heshtjes se vazhdueshme administrative të zyrtareve përgjegjëse të Komunës së Lipjanit ankuesi me datë 05.05.2021 parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të mos zbatimit të Vendimit me numër Nr.112-10129 të datës 19.02.2021 të Kryetarit të Komunës se Lipjanit, me pretendimin se organi i punësimit ka bërë shkelje thelbësorë të dispozitave ligjore dhe shkelje procedurale.

Lidhur me shqyrtimin e Pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji për shqyrtimin e ankesave i është referuar dispozitave ligjore të Ligjit Nr.03/L-149 Për Shërbimin Civil i zbatueshëm në kohën e pezullimit parandalues të ankuesit sipas Vendimit me numër Nr.1-116-6255 të datës 15.02.2017, përkatësisht nenit 63 paragrafi 5, me të cilin është përcaktuar se: *5.Nëse nëpunësi civil i akuzuar për kryerje të veprës penale shpallet i pafajshëm: 5.1. ai/ajo do të kthehet në vendin e punës dhe në dosje nuk do të përfshihet asnjë përmendje e procedurës penale dhe/ose pezullimit parandalues; 5.2. asnjë masë disiplinore nuk do të merret kundër nëpunësit civil pas shpalljes i/e pafajshëm ose përjashtimit nga një procedurë penal, si dhe nenin 69 paragrafi 3 të Ligjit si me lartë, me të cilin është përcaktuar se: Nëse nëpunësi përkatës civil më pas rikthehet në shërbim, qoftë për shkak se akuza kundër tij/saj nuk ka mundur të dëshmohet, për shkak të dyshimit ose arsyeve të tjera teknike, ai/ajo duhet të konsiderohet se është pezulluar nga ushtrimi i detyrës. Periudha e mungesës do të trajtohet si periudhë e qëndrimit në detyrë për të gjitha qëllimet dhe nëpunësi civil duhet të marrë rrogën e plotë dhe mëditjet të cilat ai/ajo do t'i kishte marrë nëse nuk do të ishte pezulluar nga shërbimi, dhe si rrjedhojë Kolegji ka konstatuar se pretendimet ankimore të ankuesit janë të bazuara gjegjësisht organi i punësimit respektivisht Kryetari i Komunës së Lipjanit është i detyruar që brenda afatit të përcaktuar në dispozitivin e këtij vendi, ti kompensoj ankuesit 50 % të pagës se ndalura nga data e Vendimit për pezullim parandalues Nr.1-116-6255 të datës 15.02.2017, deri në kthimin e tij në vendin e punës sipas Vendimit Nr.1-112-10129 të datës 19.02.2021.*

Nga ajo që u tha me lartë, dhe bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafi 1. 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr./L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i organit të punësimit, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.360/2021

Çlirim Zeka


Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj - Demi

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Lipjanit;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Komunës së Lipjanit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

